



ZINXHIRI I VLERËS NË SEKTORIN E PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE NË KOSOVË



ZINXHIRI I VLERËS
NË SEKTORIN E
PËRPUNIMIT TË
PEMËVE DHE
PERIMEVE NË
KOSOVË



Përgatitur nga:

Dr. Sc. Iliriana Miftari

Me mbështetjen e konsulentëve të projektit:

Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj

Hartim Gashi

Mirënjohje:

Puna kërkimore dhe raporti kanë përfituar nga mbështetja, komentet dhe inputet e vlefshme nga stafi i projektit CETEP-GIZ dhe është menaxhuar nga Shoqata e Përpunuese të Pemëve dhe Perimeve të Kosovës - PePeKo



SHOQATA E PËRPUNUESVE TË PEMËVE DHE PERIMEVE – PEPEKO

Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve në Kosovë, PEPEKO është një entitet jofitimprurës, i krijuar në vitin 2014 dhe i regjistruar ligjërisht si shoqatë në Tetor 2015. Objektivi kryesor i shoqatës është mbrojtja e interesave të përpunuesve vendor në mënyrë që të zhvillohet më tej industria e pemëve dhe perime të përpunuara, si dhe të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë përmes zinxhirit të vlerës.

Shoqata tashmë ka filluar me aktivitetin e saj, dhe tani po merr formën e entitetit që t'i mbështes anëtarët e saj dhe të kontribuojë në mirëqenien e përgjithshme të tërë sektorit.

Shoqata ka organizuar disa aktivitete, si:

- Koordinimin e takimeve me bartësit kryesor të sektorit;
- Aplikimin për projekte të përbashkëta për organizimin e zinxhirit të furnizimit;
- Organizimin e vizitave të kompanive në regjion dhe vendet e Bashkimit Europian;
- Pjesëmarrjen në Panaire tregtare vendore dhe ndërkombëtare për promovimin e produkteve të përpunuara të pemëve dhe perimeve;

Shoqata momentalisht ka shtatë anëtarë, prej të cilëve tre janë themelues të shoqatës.

Interesimi për anëtarësim është shumë i lartë dhe pritet të rritet brenda dy viteve të ardhshme. Kjo iniciativë do të sigurojë që Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve të Kosovës të jetë plotësisht e panvarur dhe e qëndrueshme për të ofruar shërbime për anëtarët e saj. Shoqata ka treguar potencialin dhe nevojën e saj në sektor. Sidoqoftë, përvoja dhe mosekzistenca e një shoqate në të kaluarën ka penguar zhvillimin e sektorit të pemëve dhe perimeve.

Bizneset lokale kanë identifikuar nevojën dhe rëndësinë për tu organizuar në grupe interesi. Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve është një lojtar shumë i rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, duke përfaqësuar një urë për më shumë se 8,000 kultivues të pemëve dhe perimeve dhe konsumatorëve në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Me zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë projekt, shoqata do të forcohet dhe do të jetë në gjendje të vazhdojë kontributin e saj në zhvillimin e sektorit të pemëve dhe perimeve në Kosovë.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE	6
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	8
1. HYRJE	8
2. PASQYRË E SEKTORËVE TË PËRZGJEDHUR TË BUJQËSISË.....	9
3. METODOLOGJIA.....	19
4. GJETJET KRYESORE	20
4.1 Kapacitetet e prodhimit dhe përpunimit.....	20
4.2 Punësimi.....	20
4.3 Kanalet e shpërndarjes në zinxhirin e vlerës	22
4.4 Marrëdhëniet e zinxhirit të vlerës.....	27
5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	28
BIBLIOGRAFIA	30

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Zona e kultivuar me perime në Kosovë, 2012-2018.....	9
Tabela 2: Prodhimi total në tonë i perimeve kryesore në Kosovë, 2012-2018	11
Tabela 3: Zona e korrjeve të perimeve në ha për periudhën 2014-2018	14
Tabela 4: Zona e kultivuar me frutat kryesore në Kosovë, 2012-2018.....	14
Tabela 5: Prodhimi total në tonë i frutave kryesore në Kosovë, 2012-2018.....	15
Tabela 6: Zona e kultivuar me fruta në ha për periudhën 2014-2018.....	16
Tabela 7: Statistika përshkruese të punësimit nga kompanitë e përfshira në studim	21
Tabela 8: Statistika përshkruese të punësimit sipas gjinisë.....	21

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Zona e kultivuar me domate, tranguj dhe specat të gjelbër, 2012-2018.....	10
Figura 2: Prodhimi i domateve, trangujve dhe specave të gjelbër, 2012-2018	12
Figura 3: Çmimet e tregut për perimet më të konsumuar në Kosovë, 2012-2018	13
Figura 4: Çmimet e tregut për frutat më të konsumuara në Kosovë, 2012-2018	15
Figura 5: Tregtia e perimeve kryesore me vendet e BE-së, 2012-2018	16
Figura 6: Shkëmbimet tregtare të frutave kryesore me vendet e BE-së, 2012-2018	17
Figura 7: Përqindja e pjesës së eksporteve nga prodhimi total	22
Figura 8: Ndikimi i çmimit në blerësit kryesorë	23
Figura 9: Koha e nevojitur për pranimin e parave pas dorëzimit të produktit	23
Figura 10: Rëndësia e informacionit për nevojat e blerësit, mundësitë e tregut, standartet e kualitetit dhe çmimet e shitjes	24
Figura 11: Konkurrenca mes kompanive dhe aktorëve tjerë të zinxhirit të vlerë	25
Figura 12: Performanca e marrëdhënies së kompanisë me ndërmjetësit e tjerë.....	26



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. HYRJJE

Në dekadën e fundit, sektori i bujqësisë ka marrë vëmendje të konsiderueshme dhe mbështetje nga Qeveria e Kosovës, si dhe nga ana e donatorëve. Mbështetja financiare nëpërmjet masave direkte të prodhuesve dhe zhvillimit rural është rritur shumë që nga viti 2007, dhe pritet që të rritet në vitet e ardhshme. Rritja e mbështetjes nga qeveria dhe nga donatorët është përcjellur me një rritje të interesit për investime nga sektori privat në industrinë e agro-ushqimit. Ekonomia e vendit është strukturuar gjithnjë e më shumë rreth vlerës zinxhirore që kontribon në Bruto Produktin Vendor (GDP) dhe punësim, po ashtu edhe në përmirësimin e bilancit tregtar. Andaj, është shumë e rëndësishme që të kemi një vlerësim të trendeve të vlerës zinxhirore të industrisë agro-ushqimore, pengesave si dhe mundësive. Duke bërë një vlerësim të tillë, politikbërësit dhe akterët e tjerë të zinxhirit të vlerës të agro-industrisë, do të mundësojnë që skema mbështetëse financiare dhe investimet në sektorin privat të jenë më efektive.

Më 2018, Shoqata e Prodhuesve të Pemëve dhe Perimeve të Kosovës "PePeKo", kreu një vlerësim themelor të situatës momentale të sektorit të pemëve dhe perimeve në Kosovë. Qëllimi i studimit ishte të analizohet zhvillimi i sektorit të pemëve dhe perimeve në dy vitet e ardhshme (2016-2017),

kapaciteteve të tanishme prodhuese, strategjitë e marketingut, potenciali i krijimit të punëve dhe ambienti biznesor. Ky studim është një vazhdim i studimit të vitit 2018. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë dhe të analizojë zhvillimet e fundit të vlerës zinxhirore të agro-industrisë me fokus në perime (specat, trangujt e vegjël dhe domatet) dhe frutat (mollat dhe dredhëzat). Studimi jep informata të zhvillimit të këtij sektori brenda dy viteve të fundit, situatën e tanishme të prodhimit primar dhe kapaciteteve përpunuese, standartet e sigurisë së ushqimit, marketingun dhe tregtinë, mundësitë për eksport, punësim, linjave të furnizimit dhe sfidat që lidhen me ambientin biznesor. Studimi adreson një seri të objektivave specifike dhe pyetjeve të hulumtimit të lidhura me zhvillimin e vlerës zinxhirore të agro-industrisë dhe përdorë të dhëna duke përfshirë burime primare dhe sekondare, instrumente të strukturuar për mbledhje të të dhënave dhe metoda analitike që mundësojnë furnizimin me një mori indikatorësh që përshkruajnë modelet e zhvillimit dhe sfidat e zinxhirit të vlerës në agro-industri. Rezultatet e këtij studimi mund të shërbejnë si referencë për zhvillimin e politikave në të ardhmën dhe të mbështesin sipërmarrësit e zinxhirit të vlerës të agro-industrisë drejtë proceseve më të mira të vendimmarrjes.



2. PASQYRA E SEKTORËVE TË ZGJEDHUR TË BUJQËSISË

Kontributi i sektorit të bujqësisë në GDP llogaritet të jetë 10.0% dhe punëson rreth 4.6% të të gjithë të punësuarëve (MBPZHR, 2018). Kjo tregon që bujqësia mbetet një sektor i rëndësishëm në ekonominë kombëtare. Brenda sektorit të bujqësisë, hortikultura mbulon rreth 40% të të gjithë prodhimit bujqësor, 30% mbulon ajo e perimeve dhe afër 8% prodhimi i frutave. Zona e kultivuar me perime në fusha të

hapura dhe serra është rritur për 4% në vitin 2017, krahasuar me 2016-tën, por ka pësuar rënie përsëri në vitin 2018 (shikoni Tabelën 1). Strukturë e njëjtë është treguar edhe në prodhimin total të perimeve (shikoni Tabelën 2). Rritja e zonave të kultivuara me pemë të frutave është edhe më e madhe – 13% në vitin 2017 (MBPZHR, 2018).

TAB. 1 ZONA E KULTIVUAR ME PERIMET KRYESORE NË KOSOVË, 2012-2018


Viti/Tipi	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Patate	3,198	2,777	3,695	3,353	3,795	4,290	3,606
Lakra	568	851	556	594	807	917	832
Lulelakër	13	29	-	32	83	47	46
Presh	93	143	44	78	70	73	72
Qepë	881	1,060	1,041	1,079	1,228	1,465	1,185
Domate	1,271	950	558	791	866	862	757
Tranguj	255	340	193	317	259	305	273
Specatë gjelbër	3,153	3,686	2,553	3,090	3,363	3,035	3,038

BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE, 2012-2018; DEPARATAMENTI PËR STATISTIKA TË BUJQËSISË DHE ANALIZA EKONOMIKE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL 2012-2018.

Nga totali i zonave të kultivuara me perime, prodhimi i domateve zë 8% dhe trangulli 3%. Një pjesë e konsiderueshme më e madhe e totalit të zonave të kultivuara me perime është ajo e specave të gjelbër (15%). Në lidhje me trendin e zonave të kultivuara, siç shihet në Figurën 1, zona e kultivuar

me domate dhe tranguj është mjaft stabile nga viti 2014 deri në vitin 2018. Situata qëndron ndryshe kur flitet për specat e gjelbër, ku zona e kultivuar ndryshon ndjeshëm nga një vit në vitin tjetër. Ndryshimi i zonave të kultivuara me domate dhe specat duket që është i lidhur me çmimet e tregut.

FIG. 1 NDRYSHIMI I ZONAVE TË KULTIVUARA ME DOMATE, TRANGUJ DHE SPECAT TË GJELBËR, 2012-2018



Nga totali i zonave të kultivuara me perime, prodhimi i domateve zë 8% dhe trangulli 3%. Një pjesë e konsiderueshme më e madhe e totalit të zonave të kultivuara me perime është ajo e specave të gjelbër (15%).

TAB. 2 PRODHIMI TOTAL I PERIMEVE KRYESORE NË KOSOVË TË PARAQITURA NË TON, 2012-2018


Viti/Tipi	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Patate	33,407	50,847	64,027	70,678	98,583	118,250	68,790
Lakra	13,975	21,924	14,426	16,694	25,957	25,184	21,997
Lulëlakër	169	1,793	-	218	1,571	911	725
Presh	1,293	2,206	640	1,942	1,831	1,671	1,303
Qepë	8,601	15,308	12,812	13,795	19,814	22,436	16,317
Domate	13,693	17,291	17,386	24,333	27,215	24,698	22,639
Tranguj	5,239	8,975	5,428	17,365	10,428	10,204	7,009
Speca të gjelbër	50,744	72,928	57,921	55,469	68,849	62,934	49,907

BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE, 2012-2018; DEPARTAMENTI PËR STATISTIKA BUJQËSORE DHE ANALIZA EKONOMIKE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL 2012-2018.

Kosova ka prodhimin më të madh me speca në rajon, rreth 20 ton/ha. Shumica e fermave të specave komerciale (>2ha) dhe gjysmëkomerciale (0.5-2.0 ha) gjenden në Rahovec dhe Gjakovë. Prodhimi i specave është i dominuar nga fermat e vogla që llogaritet të prodhojnë 64% të totalit të specave, të ndjekura nga fermat gjysmëkomerciale (30%) dhe fermave komerciale (6%). Përdorimi total vendor i perimeve, në veçanti i domateve, specave dhe patateve, është rritur në dy vitet e fundit (2017-2018), dhe pritet që të rritet më shumë si rezultat i rritjes së fuqisë blerëse të konsumatorëve dhe shprehive të shëndetshme të konsumimit. Perimet duket që janë të rëndësishme në dietën e konsumatorëve

kosovar, gjithsesi, jo aq të rëndësishme sa janë në dietat e konsumatorëve rajonal. Sipas Planit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, konsumimi vjetor i perimeve të freskëta për kokë banori në Kosovë llogaritet të jetë 146 kg, që është më e ulët se sa ajo na rajon – Shqipëria (173 kg/ kokë banori), Bosnja e Hercegovina (168 kg/kokë banori) dhe Maqedonia e Veriut (156kg/përkokëbanori). Ndërsa, konsumimi i perimeve të përpunuara, krahasuar me perimet e freskëta, në Kosovë është më i ulët – 1.5 kg/kokë banori (BE 8-12 kg/kokë banori) (Fischer, CH, 2002). Konsumimi i ulët i perimeve të përpunuara mund të shpjegohet nga fakti se familjet në Kosovë përpunojnë perimet në shtëpi.


FIG. 2 PRODHIMI I DOMATEVE, TRANGUJVE DHE SPECAT TË GJELBËR, 2012-2018



Prodhimi i perimeve, sidomos në fusha të hapura, mbetet i vogël dhe kjo mund të jetë si rezultat i strukturave të fermave – fermat me madhësi të vogël me fragmentim të lartë të tokës dhe teknologji të vjetëruar të prodhimit. Zona e kultivimit me domate dhe tranguj u zvogëlua në vitin 2018, krahasuar më 2017, përveç zonës së kultivuar me specat të gjelbër që ka mbetur njëjtë. Zonat e kultivuara me domate më 2018 ishin 12% më pak se në vitin 2017 dhe 10% më pak në tranguj. Prodhimi total i domateve dhe trangujve ndjeko rrugën e njëjtë si të zonave të kultivuara; kishte një rënie prej 8% dhe 30% në prodhimin total të domateve dhe trangujve respektivisht më 2018. Edhe pse zona e kultivuar me specat të gjelbër ishte pothuajse e një-

jtë më 2017 dhe 2018, prodhimi total më 2018 ishte rreth 20% më pak se ai në vitin 2017. Pavarësisht prodhimit dhe përfitimit të ulët, kërkesa për shumicën e perimeve që konsumohen më së shumti në Kosovë (patatet, domatet, specat, kungujt, trangujt, shalqiri, pjepri, lakra, qepët dhe fasulet) pati një trend në rritje. Çmimet e tregut për perime kanë prirje që të variojnë në veçanti për specat e gjelbër dhe domatet, që konsiderohen se janë perimet më të kërkuara. Çmimi i domateve për kilogram ishte 15% më i lartë më 2018 se sa më 2017, dhe çmimi për specat e gjelbër ishte edhe më i lartë (35%). Çmimi mesatar i tregut për tranguj në vitin 2018, gjithsesi, ishte i njëjtë me mesataren më 2017.

FIG. 3 ÇMIMET E TREGUT PËR PERIMET MË TË KONSUMUARA NË KOSOVË, 2012-2018



BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE, 2012-2018; DEPARTAMENTI PËR STATISTIKA BUJQËSORE DHE ANALIZA EKONOMIKE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL 2012-2018.



Çmimi i domateve për kilogram ishte 15% më i lartë më 2018 se sa më 2017, dhe çmimi për specat e gjelbër ishte edhe më i lartë (35%). Çmimi mesatar i tregut për tranguj në vitin 2018, gjithsesi, ishte i njëjtë me mesataren më 2017.

TAB. 3 ZONA E KORRJEVE TË PERIMEVE NË HA PËR PERIUHDËN 2014-2018

	2014	2015	2016	2017	2018	Mesatare	Pjesëmarrja në çdo korrje në zonën totale në%, 2018	Ndryshimi 2018 / 2014 në ha	Ndryshimi 2018 / 2014 në %
Patatet	3,695	3,353	3,795	4,290	3,606	3,531	36.76	-189	-4.98
Lakra	556	594	807	917	832	732	8.48	25	3.09
Lulelakra	-	32	83	47	46	42	0.46	-37	-44.57
Presh	44	78	70	73	72	82	0.73	2	2.857
Qepa	1,041	1,079	1,228	1,465	1,185	1,134	12.08	-43	-3.50
Domatet	558	791	866	862	757	865	7.71	-109	-12.58
Trangujt	193	317	259	305	273	277	2.78	14	5.40
Specat e gjelbër	2,553	3,090	3,363	3,035	3,038	3,131	3	-325	-9.66
Total Area	8,640	9,334	10,471	10,994	9,809	9,788	100	-662	-6.32

BURIMI: SAK, INTERVISTIMI I FERMAVE BUJQËSORE, 2014-2018

Frutat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të zonës së kultivuar bujqësore dhe llogaritet të jetë 23%. Ndër frutat: molla, kumbulla dhe shalqiri, janë ndër më të kultivuarat dhe përfshijnë deri në 5.560 ha. Rritje të ndjeshme është vërejtur gjatë tri viteve të fundit në zonën e kultivuar me shalqinjë. Frutat tjera si: dardha, qershitë dhe pjepëri, janë të kultivuara në zona më të vogla. Dredhëzat dhe manaferrat kanë një pjesë modeste dhe prodhohen në masë të vogël; gjithsesi, ato përfaqësojnë një mundësi

të rëndësishme në treg dhe vëmendje speciale u është kushtuar atyre nga politikbërësit. Prodhimi mesatar i dredhëzave është më i vogël (3.1 ton/ha) sesa mesatarja e arritur në vendet rajonale, që është 4 ton/ha. Zona e kultivuar me molla më 2018 është rritur me 18% në krahasim me vitin 2017, ndërsa prodhimi total është ndjeshëm më i madh më 2018 (98%). Mesatarja e çmimit të tregut për mollë ka rënë 17% në vitin 2018 në krahasim me vitin paraprak.

TAB. 4 ZONAT E KULTIVUARA ME FRUTAT KRYESORE NË KOSOVË, 2012-2018

Viti/Tipi	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Dardha	326	561	210	367	416	456	479
Molla	1,725	2,024	1,973	1,972	2,076	2,155	2,556
Qershitë	50	88	51	27	73	78	82
Kumbulla	1,404	1,843	699	1,518	1,518	1,524	1,821
Shalqiri	847	827	781	781	1,127	1,201	1,182
Pjepri	271	455	167	193	301	388	298


BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE, 2012-2018; DEPARTAMENTI PËR STATISTIKA BUJQËSORE DHE ANALIZA EKONOMIKE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL 2012-2018.

TAB. 5 PRODHIMI TOTAL NË TONË I FRUTAVE KRYESORE NË KOSOVË, 2012-2018

Viti/Tipi	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Dardha	1,562	4,259	210	3,189	3,966	2,083	3,500
Molla	8,120	16,786	1,973	18,352	27,485	13,159	26,093
Qershitë	167	354	51	99	405	298	410
Kumbulla	17,514	24,433	699	17,543	12,722	7,393	10,643
Shalqiri	17,080	17,641	16,669	17,404	29,997	28,740	22,918
Pjepri	2,455	4,824	1,778	2,966	5,558	6,113	4,141

BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE, 2012-2018; DEPARTAMENTI PËR STATISTIKA BUJQËSORE DHE ANALIZA EKONOMIKE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL 2012-2018.

FIG. 4 ÇMIMET E TREGUT PËR FRUTAT MË TË KONSUMUARA NË KOSOVË, 2012-2018



BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE, 2012-2018; DEPARTAMENTI PËR STATISTIKA BUJQËSORE DHE ANALIZA EKONOMIKE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL 2012-2018.

Siç mund të shihet në Figurën 4, çmimet e tregut për konsumatorë për mollë dhe shalqinjë ishin stabile në periudhën 2012-2018. Çmimet për frutat


e tjera, në veçanti për qershinë, kumbullën dhe pjeprin ishin të ndryshueshme gjatë periudhës së njëjtë kohore.

TAB. 6 ZONA E TË KORRAVE NË HA PËR PERIUDHËN 2014-2018

ha	2014	2015	2016	2017	2018	Mesatare	Pjesëmarrja e secilës korrje në zonën totale në %, 2018	Ndryshimi 2018 / 2014 në ha	Ndryshimi 2018 / 2014 në %
Dardha	210	367	416	456	479	385.6	7.46	63	15.14
Molla	1,973	1,972	2,076	2,155	2,556	2146.4	39.82	480	23.12
Qershia	51	27	73	78	82	62.2	1.27	9	12.32
Kumbulla	699	1,518	1,518	1,524	1,821	1416	28.37	303	19.96
Shalqiri	781	781	1,127	1,201	1,182	1014.4	18.41	55	4.88
Pjepri	167	193	301	388	298	269.4	4.64	-3	-0.99
Zona Totale	3881	4858	5511	5802	6418	5294	100	907	16.45

BURIMI: SAK, SONDAZHI I BUJQËSISË SHTËPIAKE, 2014-2018.


FIG. 5 TREGTIA E PERIMEVE KRYESORE ME VENDET E BE-SË, 2012-2018



Bilanci tregtar i perimeve dhe frutave të njëjta sikur prodhimeve tjera agro-ushqimore mbetet problematik. Pjesa e eksporteve të perimeve relevante me importet është rritur për një nuancë më 2018, por nuk ka përmirësim të dukshëm në bilancin tregtar të perimeve për periudhën kohore 2012-2018. Situata qëndron edhe më keq për tregtinë e frutave ku Kosova, më 2018, eksportoi vetëm 12% të vlerës së importit të frutave. Partnerët kryesorë të eksportit për Kosovën brenda BE-së ishin Gjermania, Italia dhe Sllovenia. Ndër

vendet e Europës Juglindore (SEEs), Kosova kryesisht ka eksportuar produkte agro-ushqimore në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut dhe në një masë më të vogël në Serbi dhe Kroaci. Sa i përket importit të produkteve agro-ushqimore nga BE-ja: Gjermania, Sllovenia, Italia dhe Bullgaria, mbeten partnerët kryesorë, duke përfshirë më shumë se 60% të të gjitha importeve agro-ushqimore. Ndër vendet e SEE, Kosova importon prodhime agro-ushqimore kryesisht nga: Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina.

FIG. 6 SHKËMBIMET TREGTARE TË FRUTAVE KYESORE ME VENDET E BE-SË, 2012-2018



Tregtarët: Tregtarët në vlerën zinxhimore në Kosovë përbëhen nga shitësit me shumicë dhe dyqanet me pakicë. Në rastin e produkteve të freskëta për përpunim, është më e zakonshme që fermerët u shesin drejtpërdrejt përpunuesve, por shpesh shitjet bëhen edhe përmes shitësve me shumicë. Pemët dhe perimet e prodhuara për konsum të freskët u shiten direkt tregtarëve me shumicë dhe pakicë. Janë themeluar disa qendra grumbullimi dhe disa prej tyre janë të vendosura në rajonin e Rahovecit që prodhojnë dhe mbledhin specia. Ekzistojnë qendra grumbullimi dhe depo me ftohje në rajonet kryesore të prodhimit të mjedrës (p.sh. Podujeva, Shterpcë) gjithashtu. Tregu me pakicë përbëhet nga disa zinxhirë të supermarketeve në pronësi

lokale, dyqane të vogla dhe tregje të gjelbërta. Pavarësisht rritjes së zinxhirit e të supermarketeve, është ende e zakonshme që konsumatorët të blejnë fruta dhe perime të freskëta në tregjet e gjelbërta dhe dyqane të vogla. Gjithashtu, raportohen blerje direkte nga prodhuesit që mund të ndodhin në tregjet e gjelbërta, ku fermerët gjithashtu shesin prodhimet e tyre (për më shumë, shihni seksionin e mëposhtëm në kanalet e shpërndarjes).

Furnizuesit e inpueteve: Fermerët blejnë inputet për të prodhuar kulturat e tyre, kështu që furnizuesit e inpueteve janë thelbësor në funksionimin e zinxhirit të vlerës. Furnizuesit e inpueteve merren me furnizimin e farave dhe plehrave, pajisjet bu-

jqësore, tubat e ujitjes, foli plastike, lidhjet, shufrat metalike dhe beton, etj. Ka rreth 150 tregtarë të inuteve agrokimike në Kosovë, nga të cilat 3-4 janë të njohur mirë në secilin rajon. Këta shitës të inuteve janë anëtarë të shoqatës KODAA (Shoqata e Bujqësisë së Tregtarëve të Kosovës), e cila punon së bashku me Odën Ekonomike të Kosovës. Këta tregtarë, gjithashtu, luajnë rolin jetësor të këshilltarëve për farërat, menaxhimin e dëmtuesve dhe mbrojtjen e bimëve, si dhe praktikat e tjera bujqësore. Duke iu referuar aftësive dhe transferimit të njohurive, palët e interesuara të përfshira në këtë nivel të zinxhirit të vlerës luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Më poshtë përshkruajmë kategoritë kryesore të furnizuesve me inute bujqësore.

Farërat e Perimeve: Këto kryesisht blihen nga tregtarët e tjerë të inuteve dhe zakonisht nga vende të ndryshme, siç janë: Serbia, Maqedonia e Veriut, Sllovenia dhe vendet e rajonit. Sidoqoftë, vitet e fundit, fermerët kanë blerë edhe nga: Holanda, Gjermania, Hungaria dhe vendet e tjera të BE-së. Kjo është e vërtetë veçanërisht për specat dhe perimet e tjera, ku farat hibride sigurojnë rendimente më të larta. Varietete të reja të specit kryesisht importohen dhe promovohen nga tregtarët e inuteve. Sa i përket farave të specit, veçanërisht varietetit Somborka, fermerët ende përdorin farën e tyre të ruajtur, e cila ka një ndikim negativ në rendimentin dhe cilësinë e specit të destinuar për përpunim. Varietetet Kurtovska Kapija dhe Slonovo Uvo (spec i kuq) përdoren ose nga farat e ruajtura ose blihen nga Maqedonia e Veriut ose Serbia. Për sa i përket specave djegës (feferoni), fermerët kanë marrë farëra nga Maqedonia e Veriut në të kaluarën, por aktualisht ata po shikojnë mundësi për të marrë këto varietete nga Hungaria dhe Turqia.

Fidanet e perimeve: Shumica e fermerëve që prodhojnë specat po prodhojnë fidanët e tyre në mënyrën tradicionale, duke përdorur serra të vogla ose tunele. Cilësia e fidaneve është ende e ulët dhe ka një ndikim negativ në rendiment. Kostoja për fidan është midis 3 dhe 5 cent. Në Shqipëri, ka serra të specializuara që përdoren për të prodhuar

vetëm fidane të kontraktuar nga fermerët, në këtë rast edhe pse kostoja është e ngjashme ose pak më e lartë, cilësia është më e mirë. Ky sistem mund të ishte ndërtuar edhe në Kosovë, por kërkon kohë dhe ndryshim të sistemit për kultivuesit.

Plehrat dhe Pesticidet: Këto inute kryesisht importohen, përveç plehut organik. Mungon zgjedhja e plehrave dhe shumica e tregtarëve zakonisht importojnë NPK 15:15:15, e cila në shumë raste nuk i plotëson standardet e cilësisë. Vitet e fundit, ka pasur disa ndryshime pozitive, por më shumë informacion mbi kërkesat e secilit zinxhir vlerash duhet të jenë të disponueshme, dhe shitësit e inuteve duhet të furnizojnë llojet e kërkuara të plehrave. Ekzistojnë vetëm disa importues të plehrave, të cilët importojnë kryesisht nga: Serbia, Maqedonia e Veriut, Greqia, Austria dhe Ukraina.

Pesticidet importohen si nga BE-ja, ashtu edhe nga rajoni i Ballkanit: Maqedonia e Veriut, Serbia, por edhe nga Hungaria, Sllovenia, Polonia dhe Gjermania, ndërsa ka disa ndërmarrje që furnizojnë me pesticide nga Jordania dhe vendet e tjera të Lindjes së Mesme. Kompanitë zakonisht janë përfaqësues të kompanive shumë të njohura, si: Bayer nga Gjermania ose Pegasus nga Jordania. Cilësia e pesticideve është e diskutueshme, pasi ndonjëherë këto pesticide ripakëtohen në Serbi dhe përqendrimet e përbërësve aktiv janë të pasaktë. Në disa situata, pesticidet e rekomanduara nuk janë në dispozicion dhe fermerët udhëtojnë brenda Kosovës ose Serbisë për t'i gjetur ato.

Makineritë dhe pajisjet: Ka kompani të specializuara që shesin makineri dhe pajisje p.sh.: Bibaj, Haxhijaha etj. Në sektorin e frutave dhe perimeve nuk ka shitës dhe për shkak të çmimeve të larta, fermerët blejnë më pak makineri dhe pajisje se më parë. Traktorët janë kryesisht 35 - 45 KfW, dhe për perimet, fermerët përdorin traktorë Goldoni pasi ata lehtë mund të lëvizin midis radhëve. Shumë fermerë janë ende duke përdorur traktorë dhe makineri të prodhuara më shumë se 20 vjet më parë në Serbi ose Kroaci.



3. METODOLOGJIA

Metodologjia e studimit të zinxhirit të vlerës pasqyron qasje të ndryshme. Të dhënat sekondare të realizuara në fazën e hershme të projektit siguron informacione mbi zhvillimin e sektorit dhe zinxhirët e vlerave të zgjedhura. Studimi i zinxhirit të vlerave ndjek metodën e përdorur nga FAO (p.sh. FAO, 2007 dhe FAO, 2014). Të dhënat sekondare shërbyen si bazë për zhvillimin e pyetësorit dhe mbledhjen e të dhënave primare. Intervistat me njëmbëdhjetë kompani të përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë janë realizuar gjatë korrikut-gushtit 2019 nga ekspertët. Pyetësi mblodhi informacione mbi punësimin, prodhimin, kanalet e shpërndarjes, kontratat, shitjet dhe standardet e cilësisë. Qëllimi i studimit të zinxhirit të vlerës ishte:

- për të marrë informacion dhe për të kuptuar më mirë ndryshimet e prodhimit në dy vitet e fundit dhe modelet e zhvillimit të tregut në Kosovë, sfidat dhe mundësitë, me fokus në zinxhirët e vlerave të pemëve dhe perimeve të përpunuara;
- të zhvillojë koordinimin e zinxhirit të vlerës dhe qasjen në treg;
- të përparojë drejt standardeve të sigurisë dhe të cilësisë dhe të analizojë implikimin e qasjes në treg të institucioneve përkatëse.



4. GJETJET KRYESORE

4.1 PRODHIMI DHE KAPACITETET E PËRPUNIMIT

Industria e përpunimit të pemëve dhe perimeve përbëhet nga të paktën 12 kompani përpunuese. Kapaciteti aktual i kompanive për përpunimin e pemëve dhe perimeve nuk përmbush kërkesën e tregut të brendshëm. Shumica e përpunuesve lokal janë të vegjël me linjat e produkteve që përbëhen nga: turshi, lëngje, perime të konservuara, ajvar, marmeladë dhe reçel. Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve në Kosovë po rritet dhe teknologjia e saj e përpunimit po përmirësohet. Duke marrë parasysh kapacitetet e tyre të përpunimit, ato mund të klasifikohen në tri kategori:

- Përpunues industrial (5 kompani)
- Përpunues të shkallës mesatare (7 kompani)
- Përpunues të shkallës së vogël

Vetëm pesë nga 12 ndërmarrjet e intervistuar kanë deklaruar kapacitete prodhuese dhe përpunuese, të cilat arritën në total 2,445 ton për vitin 2018. Kapaciteti përpunues në vitin 2017 ishte 5,164 ton, por kjo përfshin kapacitetet përpunuese të pesë ndërmarrjeve nga 11 të përfshira në studim. Rreth 50% e ndërmarrjeve të intervistuar kanë rritur përpunimin e pemëve dhe perimeve në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, 40% e kanë ulur atë, ndërsa pjesa tjetër 10% u përpunua diku në të njëjtën sasi si një vit më parë. Furnizimi me lëndë të parë është kryesisht (mbi 80%) nga prodhuesit vendor, dhe pjesa tjetër plotësohet me importe. Referuar vlerësimit të mëparshëm fillestar të realizuar nga PePeKo dhe rezultateve të marra në anketë, vërehet se kapacitetet përpunuese të frutave dhe perimeve kanë një prirje pozitive nga 2015 në 2018.

4.2 PUNËSIMI

Të gjithë përfaqësuesit e intervistuar të kompanive përpunuese ishin meshkuj, me një moshë mesatare 43 vjeç dhe përgjithësisht me një diplomë bachelor të përfunduar kryesisht në fushën e ekonomisë. Vetëm dy nga 12 intervistuesit kishin mbaruar arsimin e tyre në bujqësi dhe në teknologji ushqimore. Tetë nga dymbëdhjetë të intervistuarit ishin menaxher të prodhimit ose marketingut. Koha mesatare e

përfshirjes aktive në kompani ishte 6 vjet. Mesatarisht, një kompani përpunuese punëson 31 punëtorë që janë të përfshirë në aktivitete prodhuese. Numri i përgjithshëm i të punësuarve që punojnë për kompanitë e intervistuar është 1.094, nga të cilët 109 ishin të përfshirë në administrim, 378 në prodhim, 284 në marketing dhe 996 të punësuar ishin të angazhuar në aktivitete sezonale.

TAB. 7 STATISTIKA PËRSHKRUERE TË PUNËSIMIT NGA KOMPANITË E PËRFSHIRA NË STUDIM

	Total
Numri i të punësuarve që punojnë në kompani	1094
Numri i puntorëve administrativë	109
Numri i puntorëve të përfshirë në prodhim	378
Numri i të punësuarve të përfshirë në marketing	284
Numri i puntorëve sezonalë	996

Rreth 50% e kompanive të intervistuar deklaruan se numri i të punësuarve është rritur në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, 30% kishin të njëjtin numër të punësuarve, dhe 20% të tjerë kishin

zvogëluar numrin e të punësuarve në 2018. Një model i ngjashëm vërehet edhe për ndryshimet në punëtorët sezonal midis 2017 dhe 2018.

TAB. 8 STATISTIKA PËRSHKRUERE TË PUNËSIMIT SIPAS GJINISË

	Total
Numri i të punësuarve me orar të plotë meshkuj	133
Numri i të punësuarve me orar të plotë femra	276
Numri i të punësuarve me orar të përgjysmuar meshkuj	38
Numri i të punësuarve me orar të përgjysmuar femra	127
Numri i të punësuarve sezonalë meshkuj	241
Numri i të punësuarve sezonalë femra	392




Numri i përgjithshëm i të punësuarve që punojnë për kompanitë e intervistuar është 1.094, nga të cilët 109 ishin të përfshirë në administrim, 378 në prodhim, 284 në marketing dhe 996 të punësuar ishin të angazhuar në aktivitete sezonale.

4.3 KANALET E DISTRIBUIMIT NË ZINXHIRIN E VLERËS

Analiza e kanaleve të distribuimit bazohet në të dhëna sasiore dhe cilësore. Kanalet kryesore të shpërndarjes për frutat dhe perimet e përpunuara janë me pakicë dhe shumicë. Mbi 70% e kompanive të intervistuar shesin produktet e tyre të përpunuara tek shitësit me pakicë; megjithatë, përqindja e sasisë së shitur përmes këtij kanali është e vogël (rreth 30%). Pjesa tjetër u shitet shitësve me shumicë, bare, restorante, ose direkt konsumatorëve. Në 70% të rasteve, kompanitë ua shesin blerësve të njëjtë

për shkak të kontratave të shkruara ose pagesës në kohë. Katër nga 12 ndërmarrje shumicën e frutave dhe perimeve të tyre të përpunuara i shesin tek shitësit me shumicë. Rreth 42% e kompanive të intervistuar ishin në gjendje të eksportonin. Nga këto pesë kompani që ishin në gjendje të eksportojnë, është bërë një analizë mbi pjesën e eksportit nga prodhimi i përgjithshëm, dhe kjo pjesë e eksporteve varion nga 10 në 100%. Katër nga pesë kompani eksportojnë më shumë se gjysmën e prodhimit të tyre.


FIG. 7 PËRQINDJA E PJESËS SË EKSPORTEVE NGA PRODHIMI TOTAL



Mbi 80% e kompanive të përfshira në studim kanë kontraktuar gjatë gjithë vitit blerësit e tyre kryesor. Komunikimi i tyre me blerësit kryesor është i rregullt. Vetëm dy nga 12 ndërmarrjet e përfshira

në anketim nuk kishin kontratë të nënshkruar me blerësit kryesor, kjo kryesisht për shkak të zgjedhjeve të blerësve të tyre. Pothuajse 60% e kompanive deklaruan se nuk kanë ndikim në çmime.


FIG. 8 NDIKIMI I ÇMIMIT NË BLERËSIT KRYESOR



Pothuajse të gjitha kompanitë (80%) të përfshira në anketim treguan se forma kryesore e pagesës është përmes bankës. Edhe pse shumica e kompanive kanë kontrata me shkrim me blerësit kryesor, shumica e tyre deklaruan se kishin vonesa në marrjen e parave kryesisht nga blerësit lokal pas dorëzimit të produkteve. Për shembull, megjithëse kontrata parashikon që pagesa do të pranohet të paktën 60 ditë pas pranimit të produkteve; ndërsa, në shumicën e rasteve, atyre u duhet të presin deri në 120 ditë. Si rezultat, shumë nga ndërmarrjet përballen me problem të likuidimit, pasi ato nuk

janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre afatshkurtra, siç janë: ripagimi i kredive, pagimi i faturave operacionale për furnitorët e tyre dhe nganjëherë pagimi i pagave të punonjësve. Në 70% të rasteve, produktet porositen javë më parë nga blerësit. Ndërsa pothuajse 60% e prodhimit eksportohet, kjo do të thotë që produktet duhet të transportohen në distanca më të gjata, dhe kjo është arsyeja që porosia pranohet disa javë më parë dhe zakonisht duhen tre deri në katër ditë për të arritur në destinacion, por brenda ditës nëse porosia është nga blerësit lokal.


FIG. 9 KOHA E NEVOJITUR PËR PRANIMIN E PARAVE PAS DORËZIMIT TË PRODUKTIT



Rreth 70% e kompanive deklaruan se inspektimi i produktit para/gjatë blerjes së produkteve të tyre është forma kryesore e vlerësimit të blerësve të

tyre për standardet/cilësinë e produktit të tyre, pasuar edhe nga analiza laboratorike.

FIG. 10 RËNDËSIA E INFORMACIONIT PËR NEVOJAT E BLERËSIT, MUNDËSITË E TREGUT, STANDARTET E KUALITETIT DHE ÇMIMET E SHITJES




- Pranon informacionin për të kuptuar nevojat e blerësit
- Pranon informacionin e nevojshëm për të identifikuar mundësitë e tregut
- Pranon informacionin për kualitetin e produktit dhe standartin
- Pranon informacionin për çmimin e produktit dhe shitjen e produktit tuaj

Vetëm katër nga 10 ndërmarrjet e intervistuar janë çertifikuar me standardet ISO dhe HACCAP, ndërsa pjesa tjetër e kompanive pretenduan se ato janë akoma në proces të çertifikimit. Sidoqoftë, shumica e kompanive deklaruan se ata i dërgojnë produktet e tyre për teste të analizës së cilësisë dhe sigurisë, së paku 4 herë në vit në laboratorët vendore, siç janë: Instituti i Pejës dhe Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik. Për më tepër, të gjitha kompanitë e intervistuar e dinë origjinën e lëndës së parë, dhe gati 70% e perceptojnë sigurinë e produkteve të tyre si të larta dhe madje edhe më të larta për cilësinë e inputeve që blejnë jashtë vendit. Rreth 60% e kompanive të përfshira në studim, pohuan se agjensitë qeveritare inspektojnë shpesh objektet e tyre për standardet e sigurisë ushqimore. Një përqindje më e lartë (80%) deklaroi se agjensitë qeveritare ndonjëherë inspektojnë produktet e tyre në treg në lidhje me standardet e sigurisë ushqimore. Rreth 50% deklaruan se besojnë në institucionet që kryejnë analiza laboratorike. Pothuajse të gjitha kompanitë e intervistuar janë këshilluar nga këshilltarët e jashtëm në 2018, kryesisht për çështjet e prodhimit ose zhvillimin e produkteve të reja. Blerësit/klientët

e tyre janë burimi kryesor i informacionit në lidhje me kërkesën e tregut. Të gjitha kompanitë e përfshira në studim marrin trajnime për llogaritjen e kostove dhe fitimeve, dhe pothuajse të gjitha llogarisin kostot e prodhimit dhe fitimit të secilit produkt që përpunojnë. Rreth 90% e kompanive të intervistuar kanë marrë grante në pesë vitet e fundit, dhe shumica e kompanive (80%) e konsiderojnë si të lehtë qasjen e informacionit në lidhje me grantet qeveritare.

Pothuajse të gjithë (90%) të kompanive të përfshira në anketim janë anëtarë të grupit prodhues të përpunimit ose kooperativa, por megjithëse asnjëra prej tyre nuk kryen veprimtari të përbashkëta prodhuese me kompani të tjera, 70% e tyre kryejnë veprimtari të përbashkëta shitjeje (70% të kompanive). Të gjithë ata janë anëtarë të Shoqatës PePeKo dhe Odës Ekonomike të Kosovës dhe e konsiderojnë veten anëtarë aktiv të këtyre shoqatave, ku me ta kanë marrëdhënie shumë të mira komunikimi në baza ditore. Të gjitha kompanitë treguan gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me kompani të tjera për shitje të përbashkëta.

FIG. 11 KONKURENCA MES KOMPANIVE DHE AKTORËVE TJERË TË ZINXHIRIT TË VLERËS




Rreth 40% e kompanive të përfshira në studim pajtohen që shitjet kolektive janë me përfitim ekonomik, ndërsa një pjesë më e lartë (60%) mendojnë se realizimi i porosive të përbashkëta të materialeve paketuuese ose lëndës së parë është i dobishëm ekonomikisht. Lidhjet personale me aktorët e tjerë në zinxhirin e vlerës vlerësohen si një komponent i rëndësishëm për kompanitë përpunuese. Rreth 50% e kompanive kanë investuar në pajisje / makineri / ndërtesa në vitin 2018; ndërsa, vlera mesatare e investimit ishte 320,000 Euro. Grantet qeveritare ishin burimi kryesor i investimeve. Zhvillimi i produkteve të

reja dhe modernizimi i linjave të prodhimit u vlerësua si plani kryesor i synimeve për pesë vitet e ardhshme, dhe rreth 50% e kompanive shohin përmirësime në drejtim të qasjes në kapital në 12 muajt e fundit.

Performanca e marrëdhënieve me ndërmjetësuesit e tjerë të kompanisë kishte përmirësuar ndjeshëm shitjet e kompanisë, rritur fitimin dhe përmirësuar cilësinë e produktit dhe teknologjinë e prodhimit. Marrëdhënia e kompanisë me ndërmjetësuesit e tjerë nuk u duk e rëndësishme për sa i përket dhënies së çmimeve më të larta të shitjes.

FIG. 12 PERFORMANCA E MARRËDHËNIES SË KOMPANISË ME NDËRMJETËSIT E TJERË



Rreth 60% e kompanive duket se janë të kënaqur me nivelin e shkëmbimit të informacionit në lidhje me tregun e produktit kryesor dhe nivelin e shitjeve. Niveli i kënaqësisë është shumë më i ulët për çmimet e ofruara nga blerësit dhe korrektësinë e pagesës. Kjo u tregua edhe në vonesat e pagesës, pavarësisht nga marrëveshjet kontraktuale. Në lidhje me pyetjen se sa fleksibile janë marrëdhëniet me blerësit kryesor në lidhje me ndryshimet në kushtet fillestare të marrëveshjes për çmimet e shitjeve dhe standardin e produkteve, shumica (80%) nuk e konsiderojnë fleksibile.

Elementet si vendimi për të prodhuar, çmimet e shitjeve, kushtet në lidhje me pagesa, koha kur produkti duhet të dorëzohet tek blerësit, u konsideruan si faktorë shumë të rëndësishëm për performancën e kompanisë. Për më tepër, ndikimi i blerësve kryesor në elemente të tilla (çfarë të prodhojnë, çmimet e shitjeve, kushtet në lidhje me pagesa, koha kur produkti duhet të dorëzohet te blerësit) duket se ka një ndikim të lartë.

4.4 LIDHJET E VLERËS ZINXHIRORE

Mekanizmi i relacionit rregullon shpërndarjen në të gjithë zinxhirin e vlerës së pemëve dhe perimeve të përpunuara. Ai merr në konsideratë koordinimin vertikal dhe horizontal të zinxhirit të vlerës. Mekanizmi horizontal i koordinimit përbëhet nga kontrata me shkrim, marrëveshje verbale dhe mungesë marrëveshjesh. Për pemët dhe perimet e përpunuara, forma mbizotëruese e transaksioneve është një marrëveshje kontraktuale (për 8 nga 10 ndërmarrjet e intervistuar), e ndjekur nga një kompani me një marrëveshje verbale dhe një kompani tjetër me asnjë marrëveshje. Kur merret parasysh dimensionimi kohor i marrëdhënieve midis prodhuesve dhe blerësve, rezultatet e studimit tregojnë se marrëdhëniet shtrihen nga baza ditore deri në disa vite. Marrëdhëniet që përfshihen në baza ditore raportohen në katër raste dhe disa javë raportohen në tre raste; ndërsa, marrëdhëniet që zgjasin disa muaj deri më shumë se një vit raportohen në dy prej rasteve. Kjo formë e koordinimit vertikal është më e përhapur midis fermerëve dhe aktorëve të tjerë në zinxhirin e vlerës. Kontratat e shkruara aktualisht bëhen gjithnjë e më të pranishme, veçanërisht në marrëdhëniet midis shitësve me shumicë dhe përpunuesve. Sidoqoftë, forma e koordinimit përcaktohet gjithashtu nga lloji i produktit, pavarësisht nëse produkti priset shpejt apo është i qëndrueshëm. Përveç kontratave me shumicë, shitës me pakicë dhe supermarkete, kompanitë përdorin edhe kontrata me fermerët për të adoptuar mekanizma të koordinimit të tregut. Zakonisht takohen fermerët para fillimit të sezonit, ku diskutojnë dhe përcaktojnë çmimin, si dhe cilësinë dhe sasinë e frutave dhe perimeve të kërkuara. Në lidhje me besimin në sistemin gjyqësor për zbatimin e kontratave, rezultatet e anketës tregojnë se ka mungesë besimi në sistem. Disa nga intervistuesit deklaruan se së pari duhet të mendojnë për ndalimin e bashkëpunimit përpara se ta raportojnë rastin tek institucionet përkatëse.

Pagesat mes transferit bankar kryhen kryesisht midis shitësve me shumicë dhe kompanive përpunuese dhe blerësve në tregjet evropiane. Meqenëse pagesa kryesisht bëhet përmes transfereve bankare, koha e marrjes së parave bëhet kryesisht pas 90 ditësh. Produktet e shitura në tregun e brendshëm vlerësohen para dhe gjatë blerjes. Analizat laboratorike të

cilësisë së produktit raportohen shumë shpesh. Meqenëse frekuenca e shkëmbimit të tregut nuk është shumë e lartë, kjo rezultoi në një rritje të kostove të transaksionit për kompanitë përpunuese.

Sektori agro-ushqimor aktualisht po përballë me probleme në lidhje me marketingun dhe kanalet e shpërndarjes, si dhe probleme në lidhje me përmirësimin e standardeve të cilësisë nga BE-ja. Pjesa e supermarketeve në sektorin e shitjes me pakicë është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, duke e bërë akoma më të vështirë për përpunuesit lokal të hyjnë në treg për shkak të kërkesës më të lartë drejt sasisë, cilësisë dhe konsistencës. Prandaj, përpunuesit lokal të pemëve dhe perimeve duhet të përmirësojnë koordinimin horizontal përmes forcimit të bashkëpunimit/veprimit kolektiv, që mund të bëhet përmes grupeve të prodhuesve dhe shoqatave si PePeKo që janë përqendruar në ndërvprime të përbashkëta lokale dhe ndërkombëtare. Veprimi kolektiv mund të përmirësojë përfitimet e përpunuesve, të zvogëlojë kostot e marketingut dhe të zvogëlojë konkurrencën midis tyre, e cila gjithashtu mund të rris fuqinë kontraktuese me blerësit. Prandaj, është shumë e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi për përfitimet e veprimit kolektiv, midis përpunuesve të pemëve dhe perimeve. Përfaqësuesit e kompanive të intervistuar shprehën gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në bashkëpunim, sepse ofron më shumë përfitime dhe forcon pozicionin e tyre si prodhues. Gatishmëria për të marrë pjesë në format kolektive të organizatave reflektohet kryesisht për shitje të përbashkëta. Sidoqoftë, për të kuptuar më mirë stimujt dhe gatishmërinë e prodhuesve, për të forcuar bashkëpunimin për aktivitete të ndryshme përveç shitjeve të përbashkëta, është e rëndësishme të hetohet edhe perceptimi i prodhuesve mbi konkurrencën për shitje të produkteve në secilin sektor. Duke ditur që konkurrenca në pemët dhe perimet e përpunuara është e lartë, një hap i rëndësishëm përpara mund të jetë një ekzaminim i lidhjeve personale të prodhuesve me aktorë të tjerë të zinxhirit të vlerës, pasi ndonjëherë lidhjet personale informale nuk janë të rëndësishme vetëm për qasjen në treg, por edhe në marrjen e këshillave dhe informacion mbi teknologjinë e re.



5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Sipas rezultateve të studimit, viteve të fundit zhvillimi i sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve ka kaluar nëpër disa probleme, siç janë mungesa e konsistencës, mungesa e lëndës së parë lokale, kostoja e lartë e prodhimit për shkak të lëndëve të para të importuara, shqetësimet e likuiditetit në zinxhirin e tregëtisë me shumicë dhe pakicë, dhe kostot e larta të energjisë elektrike dhe ujit të përdorur në aktivitetet e përpunimit. Shumica e të intervistuarve favorizojnë përmirësimin e veprimtarive të tjera të përbashkëta; megjithatë, ekzistojnë pak shembuj pozitiv të bashkëpunimit në praktikë. Ata nuk kanë qasje në shërbimet e sigurimit të prodhimit. Nëse prodhimi i lëndës së parë rritet ndjeshëm në të ardhmen, operatorët kosovarë do të përballëshin me probleme në përshkallëzimin e operacioneve me nevoja përkatëse të kapacitetit përpunues, logjistikë gjithnjë e më komplekse dhe konkurrencë të ashpër nga lojtarët kryesorë, si: Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Sektori i përpunimit të frutave dhe perimeve kryesisht dominohet nga shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë, si dhe kontrata zyrtare në lidhje me përpunuesit dhe blerësit. Prodhuesit rajonal të pemëve dhe perimeve të përpunuara janë mjaft konkurrues, duke e bërë ambientin e biznesit mjaft sfidues për prodhuesit vendor. Rritja e vetëdijes për cilësinë dhe sigurinë e ushqimit duhet të përceptohet si një sinjal i fortë për kompanitë përpunuese vendore dhe që duhet ti përshtaten këtyre kushteve; përndryshe, importet do të vazhdojnë të rriten, gjë që do të ndikojë negativisht në qëndrueshmërinë e sektorit bujqësor.

Informacioni i tregut është veçanërisht thelbësor për të lidhur përpunuesit dhe blerësit e produkteve të tyre me segmentet e duhura të tregut. Përdorimi i informacionit të tregut për të marrë vendime për prodhimin dhe për të zhvilluar produkte të reja, është i ri për përpunuesit dhe aktorët e tjerë të zinxhirit të furnizimit. Natyrisht, bizneset private duhet të përfitojnë nga informacioni i tregut për të kapur mundësitë përkatëse; megjithatë, nuk është e mjaftueshme për sukses, pasi që politikëbërësit kanë përgjegjësinë të krijojnë kushtet për ta bërë mjedisin e agrobiznesit të qëndrueshëm, duke lejuar kështu konsumatorët dhe prodhuesit të vijnë në një zgjidhje mirë të ekuilibruar për të dyja palët. Në Kosovë, marrëdhënia e drejtpërdrejtë e konsumatorëve me prodhuesit ekziston për shkak të besimit historik të krijuar përmes brezave; megjithatë, me praninë e dyqaneve moderne të shitjes me pakicë dhe supermarketeve, ky besim ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme. Prandaj, ekziston nevoja për mekanizma të tjerë për të krijuar besimin e gjeneratës së re të konsumatorëve.

Faktori kryesor për zhvillimin e një sektori të aftë konkurrues dhe inovativ të përpunimit të pemëve dhe perimeve për të prodhuar produkte me cilësi të lartë, është ndërtimi i aftësive njerëzore që gjeneron njohuri të bazuara në shkencë mbi përcaktuesit e furnizimit me ushqim. Qeveria luan një rol kryesor në financimin e institucioneve dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike, të tilla si shërbime shtesë për të ndihmuar përpunuesit vendas të bëhen eksportues dhe të konkurrojnë me importuesit.

Ekziston nevoja për të zhvilluar koordinim institucional dhe komunikim ndër-organizativ, i cili mund të siguroj informacion të dobishëm dhe mbështetje efektive për përpunuesit. Shërbimet e zgjerimit luajnë një rol kryesor në shpjegimin e standardeve për përpunuesit dhe për t'i ndihmuar ata të përmbushin detyrimet dhe kërkesat sipas legjislacionit. Në të kundërtën, prodhuesit vendas do të përballen me vështirësi në shitjen e produkteve të tyre, pasi ata nuk arrijnë të përmbushin standardet e cilësisë dhe sigurisë së tregut. Paralelisht me rritjen e ndërgjegjësimit të prodhuesve dhe konsumatorëve, duhet të ketë mbështetje të përshkallëzuar financiare ndaj investimeve që mundësojnë përmirësimin e standardeve të sigurisë. Referuar politikës së BE-së për zhvillimin rural, disa nisma janë ndërmarrë për të zhvilluar sinergji midis përpunuesve vendor, të cilët mund të zgjerohen më tej drejt bashkëpunimit për zhvillimin e produkteve/shërbimeve të reja.

Informacioni në lidhje me preferencat e konsumatorit për pemët dhe perimet e përpunuara është thelbësore për marrjen e vendimeve racionale të prodhimit. Për më tepër, krijimi i një mjedisi të mundshëm, siç është promovimi i përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, janë të domosdoshme. Pritet që standardet e cilësisë të rrisin seriozitetin dhe besueshmërinë e prodhuesve dhe tregtarëve, dhe kjo ka efekte të menjëhershme pozitive në besimin e konsumatorit se nevojat e tyre do të plotësohen në sistemin ushqimor në tërësi.

Krijimi i partneriteteve të qëndrueshme publiko-private që lidhin aktorë të ndryshëm (fermerët dhe shoqatat e konsumatorëve, kompanitë e shërbimeve të shitjes me pakicë dhe ushqimit, përpunuesit dhe hulumtimet e shtrirjet universitare)

është një domosdoshmëri, jo vetëm për prodhimin, por edhe për aktivitetet përtej fermës. Një partneritet që është thelbësor për efikasitetin e zinxhirëve të furnizimit është administrimi i rrjedhës së informacionit. Menaxhimi i informacionit është i vendosur mirë në bizneset e mëdha me pakicë; sidoqoftë, duhet të adaptohet dhe zbatohet veçanërisht për marketing në një shkallë më të vogël dhe me një larmi më të madhe të operatorëve. Aktivitetet specifike – duke përfshirë rrjedhën e shkëmbimit të informacionit, sigurimin e cilësisë dhe menaxhimin e inventarit - kanë nevojë për vlerësim të kujdesshëm.

Një sfidë tjetër e rëndësishme është disponueshmëria e kapitalit njerëzor të zhvilluar mjaftueshëm, i cili kërkon investime në arsim dhe trajnim të adresuar posaçërisht për gratë dhe të rinjtë. Investimi kryesor, pra, duhet të bëhet në kapitalin njerëzor dhe aftësi organizative. Me fjalë të tjera, është e nevojshme të krijojnë ekspertizën e nevojshme në mesin e praktikuesve vendor të ushqimit për të menaxhuar bizneset e vetme, rrjetet dhe tërë zinxhirët e furnizimit duke përdorur një qasje për përmirësimin e vazhdueshëm të orientuar drejt cilësisë. Korrniza rregullative për sigurinë e ushqimit, i mbështetur nga statistika të sakta dhe të azhuruara në lidhje me sëmundjet dhe mashtrimet me ushqime, dhe nga një përpjekje e vazhdueshme për të rritur disponueshmërinë e informacionit në lidhje me rreziqet e sigurisë ushqimore dhe nivelin e rrezikut, ende ka nevojë për përmirësim. Konkuroshmëria dhe inovacioni janë të lidhura fort me aftësinë kërkimore. Prandaj, është thelbësore që përpjekjet e duhura dhe të qëndrueshme në hulumtimin dhe zhvillimin e produkteve të reja të parashikohen në planifikimin strategjik të kompanive.



BIBLIOGRAFIA

Fischer, CH. (2002). Tregu për Fruta & Perime në Kosovë dhe Studimi i Tregut Rajonal në Ballkan. Prishtine: Intercooperation.

MAFRD. (2018). Raporti i Gjelbër 2018. Prishtine: MAFRD.

Berisha, V. (2018). Vlerësim Themelor i Situatës Momentale për Fruta dhe Perime në Sektorin e Perimeve në Kosovë. Shoqata e Përpunuesve të Frutave dhe Perimeve në Kosovë PePeKo.

Agjencia e Statistika të Kosovës (2012-2018). Llogaritë Ekonomike për Bujqësi.



Implemented by

